



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

## Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2022



*Prishtinë, 2023*

## Përmbajtja

Shkurtesat .....	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE .....	7
1.1. Administrata Publike.....	7
1.2. Avokati i popullit .....	8
1.3. Shoqëria civile .....	8
1.4. Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit .....	9
1.5. Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore .....	10
2. KRITERET EKONOMIKE .....	12
1.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	12
1.2. Tatimet.....	12
1.3. Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë .....	13
3. STANDARDET EVROPIANE.....	13
3.1. Bujqësia dhe zhvillimi rurale .....	13
3.2. Energjia .....	14
3.3. Gjyqësori dhe të drejtat themelore .....	14
3.4. Mbrojtja e minoriteteve.....	17
3.5. Drejtësia, liria dhe siguria, .....	17
3.6. Menaxhimi i kufirit dhe migracioni.....	17
3.7. Arsimi dhe kultura.....	18
3.8. Mjedisi.....	19
3.9. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik.....	20
REKOMANDIMET.....	20

## Shkurtesat

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>EVS</b>	Ekipet Vepruese për Siguri
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KKSB</b>	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
<b>KLSP</b>	Këshillat Lokale për Siguri Publike
<b>MPL</b>	Ministria e Pushtetit Lokal
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>PKZMSA</b>	Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA-së

## Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për dy periudha brenda vitit Janar-Qershor dhe Korrik -Dhjetor.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e Integritit Evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

## Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 kanë raportuar 33 komuna të Republikës së Kosovës ndërsa 5 komuna (Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar. Raporti është i bazuar në 55 veprime/masa dhe 177 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga PKZMSA, nga konkluzionet e nën komiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 64 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve politike.

Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut,
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm.


Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 81% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve ekonomike.

Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësi,
- Liria dhe siguria,
- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,
- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 63% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane.

Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 69% të obligimeve të komunave që burojnë nga Agjenda Evropiane, që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.



Grafikoni 1: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane


## 1. KRITERET POLITIKE

### 1.1. Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kritereve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, 27 komuna (*Gjakovë, Gjiilan, Shtime, Ferizaj, Novobërdë, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Kaçanik, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Hani Elezjt, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Glllogoc, Skenderaj, Pejë, Rahovec Lipjan,*) është hartuar programi i trajnimeve ndërsa në 6 komuna (*Obiliq, Ranillug, Shtërpçë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klllokot*) nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 33 komuna raportuese janë 13 komuna (*Gjakovë, Lipjan, Ferizaj, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Skenderaj, Prizren, Hani Elezjt, Pejë, Partesh, Rahovec*) është hartuar Strategjia për Komunikim me Publikun ndërsa në 20 komuna (*Gjiilan, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Shtime, Kaçanik, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Glllogoc, Junik*) ende nuk është hartuar.



Grafikoni 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Po ashtu është parë nivel i ulët i hartimit të planit vjetor të komunikimit ku deri më tani vetëm 10 komuna (*Lipjan, Kamenicë, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Hani Elezjt, Pejë, Glllogoc, Junik, Malishevë*) është hartuar plani vjetor i komunikimit ndërsa 23 komuna (*Gjakovë, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Gjiilan, Subarekë, Vushtrri, Kaçanik, Dragash, Deçan, Klinë, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Partesh, Skenderaj, Rahovec, Klllokot*) nuk kanë plan vjetorë të komunikimit.

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, janë 30 komuna të cilat kanë raportuar që është duke u zbatuar ky udhëzim, në 3 komuna (*Ferizaj, Viti, Klinë*) është duke u zbatuar pjesërisht. Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit vetëm në 16 komuna janë publikuar ndërsa në 15 komuna (*Mamushë, Shtime, Subarekë, Dragash, Deçan, Obiliq Shtërpçë Ferizaj, Ranillug, Vushtrri, Viti, Fushë Kosovë, Kllokot, Partesh, Junik*) nuk publikohen rezultatet. nuk e publikojnë raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, ndërsa në 2 Komuna (*Gjakovë, Novobërdë*) publikohen pjesërisht.

Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësi/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani janë 26 komuna (*Gjakovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Novobërdë, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Gjiilan, Obiliq, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Hani Eleziti, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Viti, Klinë*) është caktuar zyrtari përgjegjës derisa në 7 komuna (*Ranillug, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Podujevë, Fushë Kosovë, Glllogoc*) nuk është caktuar.

## 1.2. Avokati i popullit

Rritja e përgjegjësisë së qeverisjes lokale karshi kërkesave/rekomandimeve nga Avokati i Popullit për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për qeverisjen lokale mbetet prioritet edhe gjatë vitit 2022, nga 33 komuna raportuese vetëm 8 komuna (*Gjakovë, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Prizren, Viti, Prishtinë, Rahovec*) janë pranuar 137 kërkesa/rekomandime, ndërsa 25 komuna (*Gjiilan, Lipjan, Shtime, Ranillug, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Shtërpçë, Deçan, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Podujevë, Hani Eleziti, Fushë Kosovë, Partesh, Junik, Skenderaj, Pejë, Glllogoc, Klinë*) nuk janë pranuar kërkesa. Prej tyre 25 kërkesa janë kthyer me përgjigje pozitive, kërkesa me përgjigje negative nuk ka pasur si kërkesat e tjera të pranuar janë në proces të shqyrtimit.

## 1.3. Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 27 komuna (*Gjakovë, Gjiilan, Malishevë, Lipjan, Obiliq, Shtime, Vushtrri, Novobërdë, Shtërpçë, Dragash, Subarekë, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Hani Eleziti, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Partesh, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Glllogoc, Viti, Klinë*) janë ndarë buxhet në vlerë prej **6,189,977.22** euro. Në 6 komuna (*Mamushë, Ferizaj, Ranillug, Deçani, Junik, Kllokot*) nuk ka ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur OJQ me 1262 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: *informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim i aplikuesve etj.* Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 18 komuna (*Gjakovë, Gjiilan, Shtime, Obiliq, Vushtrri, Shtërpçë, Kamenicë,*



*Mitrovicë Jugore, Istog, Hani Elezrit, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Pejë, Glllogoc, Dragash*) janë përkrahur 103 projekte, ndërsa në 15 komuna (*Lipjan, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Mamushë, Deçan, Kaçanik, Malishevë, Podujevë, Skenderaj, Viti, Klokot, Klinë, Rahovec*) nuk është përkrahur asnjë OJQ). Si dhe 4 Komuna (*Partesh, Junik, Hani Elezrit, Glllogoc*) nuk kanë Komunitete

#### 1.4. Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit


Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj më këtë qëllim në 10 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Mamushë, Obiliq, Vushtrri, Kamenicë, Prizren, Hani Elezrit, Pejë, Partesh*) janë organizuar trajnime dhe punëtori për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 23 komuna (*Malishevë, Lipjan, Subarekë, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kaçanik, Podujevë, Istog, Skenderaj, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Klokot, Prishtinë, Glllogoc, Klinë, Junik, Rahovec*) nuk janë organizuar trajnime.

Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 18 komuna që kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shprijë në ekstremizëm të dhunshëm si: janë mbajtur e ligjërata, janë zhvilluar fushata vetëdijësuese, janë zhvilluar takime me rinin, gra dhe strukturat arsimore me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit me radikalizëm, janë bërë diskutime në KKSB, Miratimi i Strategjisë komunale për ndalimin e veprimeve të dhunshme, . takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale, DKA dhe shkollat kanë adresuar këtë çështje përmes krijimit të rrethanave për përkrahje nga stafi pedagogjik siç janë psikologët, dhe përmes mësimdhënësve të promovojnë shprehjen e lirë dhe të adresojnë zgjidhjen e problemeve dhe evitimin/tejkalimin e problemeve dhe preokupimin e nxënësve me karakter akademik, social Etj. Ndërsa në 15 komuna (*Gjilan, Mamushë, Subarekë, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Malishevë, Skenderaj, Viti, Fushë Kosovë, Klokot, Glllogoc, Klinë, Junik, Rahovec*) nuk janë ndërmarr asnjë veprim. Në 33 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Në bashkëpunim me nivelin qendror në 20 komuna (*Gjilan, Obiliq, Ferizaj, Novobërdë, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kamenicë, Istog, Skenderaj, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Hani Elezrit, Prishtinë, Pejë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Fushë Kosovë*) janë krijuar hapësirat e sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale ose identitetit me praktikues trajnuar (pedagog, psikolog, sociolog etj.), në 10 komuna (*Gjakovë, Kaçanik, Mamushë, Lipjan, Subarekë, Shtime, Ranillug, Klokot, Junik, Rahovec*) nuk ka hapësira të tilla. Në 3 komuna (*Malishevë, Vushtrri, Podujevë*) pjesërisht.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, në 3 komuna (*Gjakovë, Malishevë, Podujevë*) janë 9 raste të paraqitura të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës në 3 komuna (*Vushtrri, Malishevë, Glllogoc*) janë paraqitu 6 raste, ndërsa në 30 Komuna nuk ka pasur raste të tilla.

Plani Lokal për Integritet është hartuar në 19 komuna (*Kamenicë, Skenderaj, Prizren, Viti, Hani Elezët, Glllogoc, Pejë, Gjakovë, Obiliq, Malishevë, Subarekë, Lipjan, Junik, Rahovec, Kaçanik, Deçan, Dragash, Vushtrri dhe Mitrovicë e Jugut*) është hartuar Plani Lokal për Integritet ndërsa në 14 komuna (*Gjilan, Shtime, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Kllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë, Istog*) nuk është hartuar ky Plan gjatë vitit 2022. Zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 33 komuna raportuese 19 komuna (*Lipjan, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Gjakovë, Deçan, Kamenicë, Skenderaj, Prizren, Kaçanik, Viti, Hani Elezët, Pejë, Glllogoc, Junik, Rahovec, Istog, Mitrovicë Jugore, Dragash*) kanë caktuar koordinatorin që raporton për planin lokal të integritetit, ndërsa 14 komuna (*Gjilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Podujevë, Fushë Kosovë, Kllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë*) nuk kanë koordinator për Planin Lokal për Integritet.



Grafikoni 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrtari i caktuar për planin e integritetit

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 30 komuna të cilat kanë ndërmarr veprimet si: *organizim i trajnimeve, kurse për gjuhën serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitete etj* ndërsa në 3 komuna (*Gjilan, Subarekë, Obiliq*) nuk kanë ndërmarr veprime. Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 28 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Mamushë, Lipjan, Subarekë, Obiliq, Shtime, Vushtrri, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kamenicë, Podujevë, Skenderaj, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Prishtinë, Pejë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Junik, Rahovec*) bëhet publikimi i akteve komunale në gjuhët zyrtare, ndërsa në 1 komunë (*Ferizaj*) publikimi i akteve bëhet pjesërisht. Në 4 komuna (*Kaçanik, Istog, Hani Elezët dhe Kllokot*) nuk ka ofruar informacione.

## 1.5. Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave të komunave janë vetëm 4 komuna (*Vushtrri, Deçan, Rahovec, Prizren*) të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 29 komuna (*Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Hani Elezët, Fushë Kosovë, Prishtinë, Partesh, Zveçan, Junik, Rahovec, Podujevë, Skenderaj, Glllogoc, Pejë, Shtime, Novobërdë, Obiliq, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Gjilan,*

*Kaçanik, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Dragash, Leposaviq, Subarekë, Ferizaj, Lipjan, Malishevë, Graçanicë, Gjakovë*) komunat ende nuk e kanë hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore kryesisht kanë qenë: *Mungesa e stafit profesional, mungesa e ekspertëve, mungesa e mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese etj.* Gjatë kësaj periudhe numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura në 3 Komuna (*Viti, Istog, Podujevë*) është 6 shkelje.

Po ashtu, 11 komuna (*Mamushë, Lipjan, Subarekë, Deçan, Klinë, Viti, Kllokot, Podujevë, Fushë Kosovë, Prizren, Rahovec*) janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave te objekteve të trashëgimisë kulturore, në 9 Komuna (*Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Shtërpçë Novobërdë, Dragash, Kaçanik, Skenderaj, Pejë*) janë siguruar pjesërisht, dhe në 13 komuna (*Malishevë, Obiliq, Shtime, Vushtrri, Ranillug, Mitrovicë Jugore, Hani Elezit, Prishtinë, Partesh, Junik, Glllogoc, Pejë, Kamenicë*) nuk janë siguruar pajisjet për monitorim. nuk janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave te objekteve të trashëgimisë kulturore. Në 2 komuna (*Gjakovë, Obiliq*) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 26 komuna (*Lipjan, Subarekë, Ferizaj, Shtime, Vushtrri, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Deçan, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Podujevë, Hani Elezit, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Rahovec, Glllogoc, Skenderaj, Pejë*), nuk janë nënshkruar. Ndërsa 2 komuna (*Gjilan, Kaçanik*) nuk kanë ofruar informacione. Në 3 komuna (*Dragash, Malishevë, Mamushë*) nuk ka kisha.

Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoçën e Madhe, komuna e Rahovecit e ka aprovuar listën me emrat e anëtarëve të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe, ky këshill tani më është aktiv. Gjithashtu komuna ka alokuar buxhet për këtë këshill në vlerë : 25,279.00 €.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar- Dhjetor 2022 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet, nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit, prandaj nuk ka pasur ndonjë veprim të Task Forcës. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit Komuna e Prizrenit gjithashtu me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi ka ndërmarrë aktivitete si: Mbrojtja e shtratit të Lumit, rehabilitimi i urave të qytetit, mbrojtja nga ujërat e zeza etj. Në Komunën e Fushë Kosovës është bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Gjithashtu me qëllim të për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 24 Komuna (*Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Lipjan, Obiliq, Ferizaj, Vushtrri, Dragash, Kaçanik, Deçan, Kamenicë, Istog, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Pejë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Junik, Rahovec*) janë realizuar këto aktivitete: *Iniciativa për themelimin e muzeut të qytetit, kontakte me ekspert të lëmisë së trashëgimisë kulturore, formimi i grupit punues në evidentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore hartimin e hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit në komunën tonë, vizita të ndryshme në objektet që janë nën mbrojtje, takime me nivelin qendrorë lidhur me mundësinë e bashkëpunimit në lëminë e trashëgimisë kulturore, fushata, restaurimi i disa Mullinjëve të ujit që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, Shpërndarja nëpër lokalitete e institucione e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore dhe Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore i hartuar nga Komuna dhe organizata CHËB me qëllim senzibilizimi e ndërgjegjësimi për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, Organizimi i debateve në shkollë, njoftime, promovime, janë përkratur aktivitete që promovojnë ndërgjegjësimin për mbrojtjen e trashëgimisë Kulturore, janë mbajtur trajnime joformale të popullatës me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të tyre në promovimin e turizmit, Organizimi i debateve në shkollë, OJQ, radio dhe paraqitja e spoteve nëpër televizione, hartimi i hartave turistike dhe broshurave për promovim të turizmit në komunën, etj.*

Ndërsa në 9 komuna (*Mamushë, Subarekë, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Podujevë, Skenderaj, Kllokot*) nuk ka pasur aktivitete gjatë kësaj periudhe të raportimi.


## 2. KRITERET EKONOMIKE

### 1.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre. Në 29 komuna janë funksionale, ndërsa 4 Komuna (*Junik, Partesh, Prishtinë, Kllokot*) nuk janë themeluar.

Numri i inspektorëve të tregut në 29 komuna (*Gjakovë, Gjiilan, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Podujevë, Istog, Skenderaj, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Kllokot, Pejë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Rahovec*) numri i inspektorëve të tregut është 59. Gjithashtu numri i inspektimeve në 30 komuna është 9215 inspektime.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 27 komuna janë mbajtur 266 dëgjime publike, ndërsa 5 komuna (*Mamushë, Kamenicë, Skenderaj, Fushë Kosovë, Prishtinë, Pejë*) nuk ka mbajtur asnjë dëgjime publik.



Grafikoni 4: Numri i inspektorëve të tregut dhe numri i dëgjimeve publike për planifikim të buxhetit

### 1.2. Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 28 komuna janë ndërmarr veprime si: *kontrolltet e vazhdueshme tek bizneset lidhur me lëshimin e kuponëve fiskal, produkteve të cilat kanë qenë pa deklaracion në gjubën zyrtare janë larguar nga shitja kurse produktet që kanë qenë pa origjinë janë sekuestruar dhe asgjësuar në prani të personave që kanë bërë tregtimin e*

tyre në mënyrë të pa ligjshme, vërejtje, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve, inspektim dhe kontrolle të vazhdueshme të lokaleve afariste, mbyllja e subjekteve ilegale, ofrimi i këshillave të nevojshme për të operuar ligjshëm etj, ndërsa në 5 komuna (Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Deçan) nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, nga 33 komuna raportuese 32 prej tyre kanë pranuar 360 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 211 rekomandime, të pa adresuara mbesin 66 rekomandime dhe pjesa tjetër gjenden në proces. Nga këto rekomandime, janë pranuar 147 rekomandime financiare.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 27 komuna, ndërsa në 6 komuna (Ranillug, Mamushë, Skenderaj, Hani Eleziti, Kllokot, Partesh) nuk funksionon. Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 22 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 8 komuna (Novobërdë, Shtime, Vushtrri, Ranillug, Kaçanik, Podujevë, Kllokot, Klinë) nuk është publikuar. Si dhe 3 komuna (Mamushë, Shtërpçë, Deçan) nuk ka ofruar informacione.

### 1.3. Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 8 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 24 komuna (Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Ferizaj, Vushtrri, Ranillug, Shtërpçë, Kaçanik, Mamushë, Deçan, Kamenicë, Podujevë, Skenderaj, Prizren, Viti, Hani Eleziti, Kllokot, Prishtinë, Pejë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Junik, Rahovec) ende nuk është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike. Ndërsa 1 komunë (Novobërdë) kanë deklaruar se nuk kanë zona ekonomike.

## 3. STANDARDET EVROPIANE

### 3.1. Bujqësia dhe zhvillimi rurale

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që vetëm 10 komuna (Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Malishevë, Dragash, Kamenicë, Podujevë, Prizren, Junik, Rahovec) kanë hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, në 22 komuna janë parashtruar 361 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës, ndërsa në 11 komuna (Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Ranillug, Istog, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Partesh, Glllogoc, Kamenicë, Klinë) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara. Krahas kësaj lidhur me këto kërkesa janë nxjerr 264 vendime nga 20 komuna, ndërsa në 13 komuna (Subarekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Dragash, Istog, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Partesh, Glllogoc, Kamenicë, Klinë) nuk ka pasur vendime të miratuara.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 27 komuna janë të funksionalizuara qendrat informative, ndërsa në 6 komuna (Ferizaj, Ranillug, Vushtrri, Podujevë, Prizren, Kllokot) ende nuk janë funksionalizuar. Janë 26 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje për 5600 fermerë për kultivimin e bujqësisë në sektorë të: blegtorisë, hortikulturës, perimtarisë, shpejtari etj, ndërsa 7 komuna (Subarekë, Novobërdë, Vushtrri, Istog, Kllokot, Pejë, Junik) gjatë këtij viti nuk kanë ofruar mbështetje për fermerët.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, vetëm 9 komuna (Lipjan, Obiliq, Kamenicë, Prizren, Pejë, Glllogoc, Junik, Rahovec, Hani Eleziti) kanë mbajtur fushata/trajtime vetëdijesuese, ndërsa 24 komuna nuk kanë mbajtur asnjë fushatë.


Janë 7 komuna të cilat kanë inspektorë të bujqësisë, derisa janë 26 komuna (*Gjilan, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Novobërdë, Ranillug, Vushtrri, Ferizaj, Obiliq, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kaçanik, Kamenicë, Podujevë, Istog, Skenderaj, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Kllokot, Prishtinë, Partesh, Junik*) të cilat ende nuk kanë inspektorë të bujqësisë. Në shumicën e komunave ku nuk ka inspektor të bujqësisë në këto raste inspektimet realizohen nga inspektori sanitar, inspektori regional, inspektori i veterinarisë, inspektori i ndërtimit, inspektorët nga Zyra Rajonale e AUVK-ut, nga niveli qendror, koordinatori i bujqësisë. Numri i inspektimeve bujqësore në 12 komuna është 3408, kurse 21 komuna (*Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Kamenicë, Ranillug, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Deçan, Kaçanik, Dragash, Podujevë, Istog, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë Rahovec*) nuk kanë pasur inspektime.

### 3.2. Energjia

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejme në politikat e fushës së eficiencës së energjisë progres i cili është specifikuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. Planin për Eficiencë të Energjisë e kanë hartuar 13 komuna, ndërsa 20 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Shtime, Obiliq, Ranillug, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Novobërdë, Shtërpçë, Kaçanik, Dragash, Klinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Skenderaj*) nuk e kanë ende këtë plan. Me qëllim të zbatimit të këtij plani, 25 komuna kanë zhvilluar një numër të lartë të projekteve kryesisht në shkolla dhe Qendra të Mjekësisë Familjare, si dhe në objektet publike të komunës ndërsa në 8 komuna (*Shtime, Deçan, Istog, Viti, Fushë Kosovë, Kllokot, Rahovec, Suharekë*) nuk ka pasur projekte.

### 3.3. Gjqësori dhe të drejtat themelore

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se deri më tani 27 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 6 komuna (*Novobërdë, Kaçanik, Deçan, Klinë, Istog, Glllogoc*) ende nuk e kanë caktuar. Sa i përket zyrtarit përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë 29 komuna të cilat i kanë caktuar këta zyrtarë ndërsa në 4 komuna (*Novobërdë, Deçan, Klinë, Pejë*) nuk janë caktuar. Kurse zyrtari për barazi gjinore është caktuar në 24 komuna, ndërsa në 9 Komuna (*Gjakovë, Novobërdë, Shtërpçë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Deçan, Partesh, Prishtinë*) ende nuk është caktuar.



Grafikoni 5: Caktimi i zyrtarëve për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku në 24 komuna janë zhvilluar aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si: *Trajnime, Punëtori, Takime, Tryeza, inkurajimin i grave për pjesëmarrje në Këshillat e fshatrave, Organizimi i debeteve për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator, Fushata vetëdijësuese për promovimin e Ligjit për Barazë Gjinore dhe Ligjit kundër diskriminimit, ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasje në shërbime, koordinimi i punës së Mekanizmit Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje, vizita dhe ligjërata në shkolla dhe në viset rurale, organizim i tryezave të rrumbullakëta, bashkëpunimi i organizatave ndërkombëtare dhe vendore për Barazinë Gjinore* etj, ndërsa në 9 komuna (Gjilan, Novobërdë, Shtërpçë, Ranillug, Ferizaj, Obiliq, Deçan, Klokot, Istog) nuk ka pasur aktivitete. Në 23 komuna (Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Vushtrri, Obiliq, Kaçanik, Kamenicë, Podujevë, Istog, Skenderaj, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Partesh, Glllogoc, Klinë, Rahovec) janë ndarë mjete buxhetore me shumë prej 76,012.00 euro për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ndërsa në komunat të tjera është raportuar që buxhet të veçantë komuna nuk ka ndarë.

Sa i përket publikimeve për njoftim të qytetarëve për të drejtat e tyre të cilat mund t'i realizojnë në institucionet kompetente, janë 19 komuna të cilat i kanë publikuar njoftimet në ueb faqe të komunave ndërsa në 14 komuna (Gjilan, Mamushë, Novobërde, Vushtrri, Shtërpçë, , Deçan, Ranillug, Obiliq, Kaçanik, Shtime, Klokot, Prishtinë Pejë, Partesh) nuk janë publikuar.

Një tjetër e gjetur nga raporti i KE-së për Kosovën ka qenë edhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje, e cila strategji në bazë të raportimeve është hartuar në 2 komuna (Malishevë, Dragash). Në 21 komuna janë paraqitur 1274 raste të dhunës, kurse në 12 komuna (Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Deçan, Kaçanik, Hani Elezit, Klokot, Partesh Glllogoc, Junik, Rahovec, Malishevë) nuk ka pasur raste të paraqitura të dhunës. Në përgjithësi komunat kanë raportuar që ndaj rasteve të paraqitura kanë ndërmarr veprime dhe kanë ofruar mbështetje. Ndërsa për rritjen e vetëdijesimit të publikut për dhunën në familje janë 21 komuna të cilat kanë ndërmarr masa/veprime ndaj viktimeve të dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje si: *vetëdijësimi i qytetarëve mbi pasojat e dhunës në familje, këshillime sociale, fushata vetëdijësuese, trajnime, broshura të shpërndara për vetëdijësim kundër dhunës,* etj. Në 9 komuna (Novobërdë, Ranillug, Kaçanik, Hani Elezit, Klokot, Partesh Glllogoc, Junik, Rahovec) nuk është ndërmarr asnjë masë, pasi që nuk ka pasur raste. Si dhe 3 komunë (Shtime, Malishevë, Deçan) nuk ka ofruar informacione.

Sa i përket themelimit të këshillit komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore, në 17 komuna është themeluar ky këshill, ndërsa në 16 komuna (*Ferizaj, Gjakovë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Shtërpçë, Kaçanik, Deçan, Klinë, Kamenicë, Podujevë, Istog, Kllokot, Junik, Rahovec, Pejë*) nuk janë themeluar ende.

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku në 33 komuna numri i femrave në pozita menaxheriale është 579. Krahas tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 33 komuna, janë të përfshira 5059 femra. Sa i përket raportit statistikor (gjinor) të drejtorëve të drejtorive komunale, në 29 komuna numri i drejtoreshave komunale është 96 ndërsa 4 Komuna (*Novobërdë, Ranillug, Kllokot, Partesh*) nuk ka asnjë drejtoresh.

Lidhur me zbatimin e të drejtave pronësore të grave në 31 komuna kanë ndërmarr veprime me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave: janë zhvilluar aktivitete me gratë e viseve rurale, lirimi i grave nga taksat komunale për regjistrimin e pronës së përbashkët, takime me grupe të grave dhe punëtori, janë shpërndarë postera dhe fletushka, janë vendosur postera nëpër vende të frekuentuara, janë organizuar fushata ndërgjegjësuese lidhur me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 02/2020 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshorteve etj. Në 2 komuna (*Shtërpçë, Shtime*) nuk janë ndërmarr veprime. Prona në emër të dy bashkëshortëve në 27 komuna janë të regjistruar 6343 ndërsa në 3 komuna (*Hani Elezit, Pejë, Partesh*) nuk ka pasur prona të regjistruara në emër të dy bashkëshorteve. Në 3 komuna (*Mamushë, Shtërpçë, Deçan*) nuk janë ofruar informacione.

Sfidë tjetër e identifikuar nga raporti i Komisionit Evropian për nivelin lokal të qeverisjes është edhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, gjë për të cilat një numër i konsiderueshëm i komunave kanë shfaqur sfidat dhe vështirësitë e tyre në zbatimin e këtij ligji si: mungesa e mjeteve financiare, mungesa e stafit profesional, numri i ulët i dëgjimeve publike, mungesa e Themelimit të Ekspertit për Mbrojtjen e fëmijës, Mungesa e hartimit të udhëzimeve administrative të cilat parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, mungesa e Grantit Specifik për Qendrat për Punë Sociale në Ligjin për Buxhetin i cili grant do t'ju mundësonte QPS-ve buxhetim të mjaftueshëm për ushtrim të rregullt të veprimtarive të tyre, mungesa e përkrabjes logjistike si vendstrehimet etj. Në 23 komuna janë caktuar zyrtarët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa në 10 komuna (*Novobërdë, Malishevë, Deçan, Viti, Kllokot, Istog, Prishtinë, Prizren, Glllogoc, Klinë*) ende nuk janë caktuar këta zyrtar. Për rritjen e vetëdijesimit mbi këtë ligj në 23 komuna janë organizuar fushata/takime vetëdijesuese me qytetarët ndërsa 10 komuna (*Subarekë, Ranillug Novobërdë, Shtërpçë, Dragash, Istog, Fushë Kosovë, Kllokot, Junik, Klinë*) nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë.

Për fuqizimin e nivelit lokal në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 4 regjione (*Gjilan, Mitrovicë Jugore, Prizren, Prishtinë*) kanë hapur dhe funksionalizuar strehimoren për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, në 8 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Prishtinë, Glllogoc, Klinë*) janë paraqitur raste të strehimit dhe kompensimit të viktimave të trafikimit për të cilat raste është siguruar ndihmë nga komunat. Ndërsa sa i përket miratimit të Planit tre-vjeçar për strehim social në 12 komuna (*Gjakovë, Shtime, Malishevë, Lipjan, Kaçanik, Deçan, Fushë Kosovë, Skenderaj, Istog, Glllogoc, Rahovec Mitrovicë Jugore*) është hartuar derisa janë 21 komuna (*Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Obiliq, Vushtrri, Subarekë, Shtërpçë, Dragash, Klinë, Kamenicë, Viti, Kllokot, Podujevë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Pejë*) të cilat ende nuk kanë hartuar këtë plan.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar është funksionalizuar në 21 komuna, ndërsa në 12 komuna (*Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Istog, Podujevë, Partesh, Skenderaj, Rahovec, Kllokot*) ende nuk është funksionalizuar. Sa i përket ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në 7 regjione (*Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë*). Ndërsa zyrat mobile për



ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 20 komuna, në 13 komuna (*Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Vushtrri, Mamushë, Shtërpçë, Deçan, Viti, Kllokot, Partesh, Junik, Rahovec*) ende nuk janë themeluar. Numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në 19 komuna është 3818.

### 3.4. Mbrojtja e minoriteteve

Për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, në 10 komuna është themeluar komiteti lokal ndërsa në 16 komuna (*Gjilan, Shtime, Novobërdë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Shtërpçë, Viti, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Rahovec*) nuk është themeluar. Në 7 komuna (*Hani Elezit, Partesh, Kaçanik, Dragash, Ranillug, Junik dhe Glllogoc*) nuk kanë komunitete rom, ashkali dhe egjiptian.

Në 9 komuna (*Gjakovë Lipjan, Subarekë, Mamushë, Deçan, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Viti*) është miratuar Planit Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian ndërsa në 17 komuna (*Shtime, Novobërdë, Malishevë, Ferizaj, Shtërpçë, Vushtrri, Obiliq, Gjilan, , Klinë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Fushë Kosovë*) ende nuk është miratuar ky plan., si dhe në 7 komuna (*Kaçanik, Dragash, Ranillug, Hani Elezit, Partesh, Junik dhe Glllogoc*) nuk kanë rom, ashkali dhe egjiptian.

Për realizimin e fushatave për regjistrim falas të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në 18 komuna janë realizuar fushata për regjistrim, ndërsa në 8 komuna (*Gjakovë, Subarekë, Gjilan, Novobërdë, Skenderaj, Viti, Pejë, Klinë*) nuk është realizuar ndonjë fushatë, si dhe në 7 komuna (*Kaçanik, Ranillug, Dragash, Hani Elezit, Partesh, Junik dhe Glllogoc*) nuk kanë rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas të dhënave të pranuar nga komunat numri i të punësuarave i komuniteteve jo shumicë sipas përqindjes, në 27 Komuna (*Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Novobërdë, Subarekë, Obiliq, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Deçan, Prizren, Skenderaj, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Podujevë, Partesh, Fushë Kosovë, Prishtinë, Rahovec, Pejë, Dragash*) është 791 të punësuar. Ndërsa në 6 Komuna nuk ka të punësuar.

### 3.5. Drejtësia, liria dhe siguria,

Një ndër sfidat e raportit të KE-së për Kosovën është edhe hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Riintegrim për të cilin plan janë 17 komuna që kanë arrit ta hartojnë ndërsa në 16 komuna (*Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Vushtrri, Ferizaj, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prizren, Viti, Rahovec, Glllogoc*) ende nuk e kanë hartuar.


### 3.6. Menaxhimi i kufirit dhe migracioni

Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur, dhe përkrahja nga niveli lokal ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Në 18 komuna (*Shtime, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Mamushë, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Istog, Skenderaj, Viti, Mitrovicë Jugore, Hani Elezit, Prishtinë, Partesh, Glllogoc, Rahovec*) numri i personave të zhvendosur është 943. Për këta persona të rikthyer në 6 komuna (*Novobërdë, Kamenicë, Prizren, Klinë, Junik, Rahovec*) janë ndërtuar 30 shtëpi.

Sa i përket aplikimit për asistencë nga fondi për ri-integrim në 17 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Subarekë, Dragash, Prizren, Junik, Klinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Glllogoc, Pejë*)

numri i aplikimeve është 230 ndërsa numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesua në 15 komuna (*Lipjan, Shtime, Obiliq, Vushtrri, Mamushë, Deçan, Dragash, Podujevë, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Prishtinë, Glllogoc, Rahovec*) është 269.

Në 32 komuna janë themeluar KKSB-të ndërsa në 1 komuna (*Novobërdë*) nuk është themeluar ende KKSB. Prej tyre janë 28 komuna që kanë mbajtur gjithsej 159 takime . Këshilli Lokal për Siguri Publike është themeluar në 22 komuna ndërsa në 11 komuna (*Gjakovë, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kamenicë, Skenderaj, Hani Elezët, Pejë*) nuk është themeluar, prej tyre janë 19 komuna që kanë mbajtur gjithsej 98 takime të KLSP-ve si dhe 14 komuna (*Gjakovë, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Shtërpçë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Hani Elezët, Prishtinë, Pejë, dragash, Deçan*) nuk është mbajtur asnjë takim . Ekipi Vepruese për Siguri është themeluar në 22 komuna si dhe në 11 komuna (*Gjakovë, Ranillug, Mamushë, Novobërdë, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Klllokot, Hani Elezët, Skenderaj* ) ende nuk janë themeluar. Prej tyre janë 22 komuna që kanë mbajtur gjithsej 43 takime të EVS-ve ndërsa 16 komuna (*Gjakovë, Shtime, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Kamenicë, Skenderaj, Prizren, Mitrovicë Jugore, Hani Elezët, Fushë Kosovë, Klllokot, Prishtinë, Klinë*) nuk kanë mbajtur asnjë takim.



Grafikoni 6: Funkcionalizimi i KKSB-ve, KLSP-ve dhe EVS-ve

Këshillat e fshatrave janë themeluar në 18 komuna ndërsa në 15 komuna (*Shtime, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Deçan, Klinë, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prizren, Junik, Skenderaj, Glllogoc*) nuk janë themeluar. Prej tyre janë 14 komuna që kanë mbajtura gjithsej 194 takime ndërsa 19 komuna (*Malishevë, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Obiliq, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Podujevë, Istog, Skenderaj, Prizren, Prishtinë, Fushë Kosovë, Glllogoc, Klinë, Junik, Mamushë, Vushtrri*) nuk kanë mbajtur asnjë takim.

### 3.7. Arsimi dhe kultura

Zhvillimi i sistemit të arsimit dhe ngritja e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës kanë vazhduar në komuna, për të cilën fushë 21 komuna kanë organizuar 397 trajnime me 5241 mësime ndërsa 12 komuna (*Ranillug, Malishevë, Shtërpçë, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Viti, Klllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë, Rahovec*) nuk është mbajtur asnjë trajnim.

Në 30 komuna janë 147 çerdheve funksionale ndërsa në 2 komuna (*Novobërdë, Mamushë*) nuk ka çerdhe. Si dhe 1 komunë (*Partesh*) nuk ka ofruar informacione.

Sa i përket rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor, në 31 komuna numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç që ndjekin arsimimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme është 9247 fëmijë ndërsa në 2 komuna (*Novobërdë, Mamushë*) nuk ka fëmijë të përfshirë të moshës 0-5 vjeç në çerdhe. Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe në 23 komuna është 195 kurse në 8 komuna (*Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Dragash, Skenderaj, Podujevë Kllokot*) nuk ka fëmijë me nevoja të veçanta. Si dhe 2 komun0 (*Prishtinë, Partesh*) nuk ka ofru informacione

Në 4 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Vushtrri, Dragash*) komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian vazhdon të përballet me sfidat kryesisht për shkak të mungesës së librave shkollore, për të cilat raste komuna Vushtrri dhe Dragash ka ngritur shqetësime në institucione përkatëse. Numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në 12 komuna (*Gjakovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Istog, Prizren, Fushë Kosovë, Prishtinë, Pejë, Klinë, Rahovec*) është 118.

Me qëllim të sensibilizimit të nevojës së shkollimit të fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë 15 komuna që kanë zhvilluar: *trajtime, projekte dhe fushata vetëdijësuese me prindërit mbi rëndësin e nevojës së shkollimit të fëmijëve të këtij komuniteti* ndërsa Në 11 komuna (*Gjakovë, Mamushë, Lipjan, Novobërdë, Vushtrri, Shtërpçë, Deçan, Skenderaj, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot*) nuk është zhvilluar ndonjë projekt. Si dhe 7 komuna (*Kaçanik, Hani Elezit, Partesh, Junik Dragash Ranillug dhe Glllogoc*) nuk kane fare RAE

Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) është i hartuar vetëm në 2 komuna (*Istog dhe Pejë*). Janë 27 komuna të cilat kanë formuar ekipet vepruese për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla si dhe në 6 komuna (*Gjilan, Novobërdë, Kllokot, Partesh, Junik, Malishevë*) nuk janë formuar. Si dhe 1 komuna (*Ranillug*) nuk ka ofruar informacione.

### 3.8. Mjedisi

Komunat mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, 17 komuna kanë hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave komunale ndërsa 16 komuna (*Gjilan, Ferizaj, Malishevë, Shtërpçë, Obiliq, Shtime, Ranillug, Subarekë, Klinë, Kllokot, Mitrovicë Jugore, Hani Elezit, Fushë Kosovë, Glllogoc, Pejë, Partesh*) ende nuk kanë hartuar këtë plan. Sfidat në të cilat hasin komunat në vazhdimësi në zbatimin Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale janë: *fondet e pamjaftueshme, vetëdijësimi i qytetarëve, mungesa e pagesave nga ana e qytetarëve, numri i vogël i inspektimeve të mjedisit, mungesa e ndërmarrjeve, stafi jo adekuat për laminë përkatëse, mungesa e pajisjeve të mjaftueshme teknike për kompaninë që menaxhon me mbeturinat, mungesa e fushatave vetëdijësuese, deponitë ilegale etj.*


Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, në 14 komuna janë zhvilluar 45 fushata ndërsa 19 komuna (*Gjilan, Ferizaj, Malishevë, Shtërpçë, Obiliq, Shtime, Ranillug, Subarekë, Gjakovë, Novobërdë, Kaçanik, Deçan, Junik, Partesh, Klinë, Kllokot, Istog, Prishtinë, Pejë*) nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë. Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave ku vetëm 2 komuna (*Glllogoc dhe Hani i Elezit*) e kanë hartuar këtë plan. Gjithashtu hartimi i raportit për zbatimin e planit për cilësinë e ajrit dhe shqyrtimi nga Kuvendet e Komunave mbetet sfidë e komunave pasi që deri më tani vetëm 1 komunë (*Glllogoc*) e ka të hartuar.

Numri i deponive ilegale në 25 komuna është 770 ndërsa në 8 komuna (*Obiliq, Shtërpçë, Deçani, Viti, Partesh, Glllogoc, Junik Podujevë*) kanë raportuar që nuk ka deponi ilegale.

### 3.9. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik

Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, janë 17 komuna që kanë organizuar fushata ndërsa në 16 komuna (*Gjilan, Mamushë, Lipjan, Ranillug, Novobërdë, Shtërpçë, Deçan, Podujevë, Skenderaj, Klllokot, Partesh, Glllogoc, Junik Gjakovë, Ferizaj, Kaçanik*) nuk ka pasur asnjë fushatë.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022, në 20 komuna janë mbajtur 68 trajnime kurse në 13 komuna Në 13 komuna (*Lipjan, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Skenderaj, Fushë Kosovë, Klllokot, Glllogoc, Partesh, Junik, Rabovec*) nuk ka pasur asnjë trajnim.



Grafikoni 7: Numri i trajnimeve për shëndetin e nënës dhe fëmijës

## REKOMANDIMET

Në bazë të dhënave të nxjerra nga raportet individuale të komunave në këtë raport, MAPL rekomandon:

- **Të hartohet Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në komunat:** *Gjilan, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Shtime, Kaçanik, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Glllogoc, Junik;*

- **Të hartohet Plani Lokal për Integritet në komunat:** *Gjakovë, Gjiilan, Shtime, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Mamushë, Shtërpçë, Ferizaj, Dragash, Podujevë, Fushë Kosovë, Kllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë*
- **Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në komunat:** *Gjakovë, Gjiilan, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Malishevë, Mamushë, Shtërpçë, Kaçanik, Dragash, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Hani Elezit, Fushë Kosovë, Prishtinë, Partesh, Junik, Podujevë, Skenderaj, Glllogoc, Pejë;*
- **Të hartohet programi i trajnimeve në Komunat:** *Obiliq, Ranillug, Shtërpçë, Podujevë, Fushë Kosovë, Kllokot;*
- **Të caktohet zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në Komunat:** *Ranillug, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Podujevë, Fushë Kosovë, Glllogoc;*
- **Të themelohen Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunat:** *Junik, Partesh, Prishtinë, Kllokot;*
- **Të hartohet Strategjia kundër dhunës në familje:** *Gjakovë, Gjiilan, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Mamushë, Shtërpçë, Vushtrri, Kaçanik, Deçan, Hani Elezit, Prizren, Junik, Skenderaj, Partesh, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Rahovec, Glllogoc, Pejë;*
- **Të hartohet Plani tre-vjeçar për strehim Social në komunat:** *Gjiilan, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Obiliq, Vushtrri, Subarekë, Shtërpçë, Dragash, Klinë, Kamenicë, Viti, Kllokot, Podujevë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Pejë;*
- **Të hartohet Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunat:** *Lipjan, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Subarekë, Vushtrri, Mamushë, Shtërpçë, Shtime, Kaçanik, Deçan, Klinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Hani Elezit, Fushë Kosovë, Prishtinë Partesh, Glllogoc, Skenderaj, Pejë;*
- **Të hartohet Plani për Efiçencës të Energjisë në komunat:** *Gjakovë, Gjiilan, Lipjan, Shtime, Obiliq, Ranillug, Subarekë, Malishevë, Vushtrri, Novobërdë, Shtërpçë, Kaçanik, Dragash, Klinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Skenderaj;*
- **Të hartohet Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunat:** *Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Vushtrri, Ferizaj, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Fushë Kosovë, Prizren, Viti, Rahovec, Glllogoc;*
- **Të hartohet plani për menaxhimin e mbeturinave në komunat:** *Gjiilan, Ferizaj, Malishevë, Shtërpçë, Obiliq, Shtime, Ranillug, Subarekë, Klinë, Kllokot, Mitrovicë Jugore, Hani Elezit, Fushë Kosovë, Glllogoc, Pejë, Partesh;*
- **Të hartohet Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat:** *Shtime, Novobërdë, Malishevë, Ferizaj, Shtërpçë, Vushtrri, Obiliq, Gjiilan, , Klinë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Istog, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Fushë Kosovë;*
- **Të hartohet plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunat:** *Gjakovë, Gjiilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Lipjan, Shtërpçë, Subarekë, Vushtrri, Kaçanik, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Partesh, Junik, Rahovec, , Skenderaj, Pejë, Kllokot;*
- **Të themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në komunën:** *Novobërdë;*
- **Të themelohet Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunat:** *Gjakovë, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kamenicë, Skenderaj, Hani Elezit, Pejë;*
- **Të themelohet Ekipi Vepruese për Siguri (EVS) në komunat:** *Gjakovë, Ranillug, Mamushë, Novobërdë, Dragash, Deçan, Klinë, Kamenicë, Kllokot, Hani Elezit, Skenderaj;*
- **Të themelohet Këshilli në Fshatra në komunat:** *Shtime, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Deçan, Klinë, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Prizren, Junik, Skenderaj, Glllogoc;*

- **Të caktohet zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi në komunat:** *Novobërdë, Kaçanik, Deçan, Klinë, Istog, Glllogoc;*
- **Të caktohet zyrtari për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në komunat:** *Novobërdë, Deçan, Klinë, Pejë;*
- **Të caktohet zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës në komunat:** *Novobërdë, Malishevë, Deçan, Viti, Klllokot, Istog, Prishtinë, Prizren, Glllogoc, Klinë;*
- **Të caktohet zyrtari për barazi gjinore në komunat:** *Gjakovë, Novobërdë, Shtërpçë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Deçan, Partesh, Prishtinë;*
- **Të caktohet koordinatori që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet në komunat:** *Gjilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Podujevë, Fushë Kosovë, Klllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë;*
- **Të organizohen fushata vetëdijësuese për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësishëm të tokave bujqësore në komunat:** *Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Novobërdë, Ranillug, Vushtrri, Shtërpçë, Dragash, Deçan, Kaçanik, Shtime, Podujevë, Istog, Skenderaj, Viti, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Klllokot, Prishtinë, Partesh, Klinë;*
- **Të organizohen fushata vetëdijësuese për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve:** *Suharekë, Ranillug Novobërdë, Shtërpçë, Dragash, Istog, Fushë Kosovë, Klllokot, Junik, Klinë;*
- **Të organizohen fushata me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit në komunat:** *Gjilan, Ferizaj, Malishevë, Shtërpçë, Obiliq, Shtime, Ranillug, Suharekë, Gjakovë, Novobërdë, Kaçanik, Deçan, Junik, Partesh, Klinë, Klllokot, Istog, Prishtinë, Pejë;*
- **Të organizohen fushata në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës në komunat:** *Gjilan, Mamushë, Lipjan, Ranillug Novobërdë, Shtërpçë, Deçan, Podujevë, Skenderaj, Klllokot, Partesh, Glllogoc, Junik, Gjakovë, Ferizaj, Kaçanik;*
- **Të ndërmerren aktivitete në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në komunat:** *Ranillug, Ferizaj, Podujevë, Klllokot, Pejë, Partesh, Deçan;*
- **Të themelohet Këshilli komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore në komunat:** *Ferizaj, Gjakovë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Shtërpçë, Kaçanik, Deçan, Klinë, Kamenicë, Podujevë, Istog, Klllokot, Junik, Rahovec, Pejë;*
- **Të themelohet komiteti lokal për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në komunat:** *Gjilan, Shtime, Novobërdë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Shtërpçë, Viti, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Rahovec;*
- **Të funksionalizohet Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunat:** *Ferizaj, Novobërdë, Ranillug, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Istog, Podujevë, Partesh, Skenderaj, Rahovec, Klllokot;*
- **Të funksionalizohet qendra informative për trajnimin e fermerëve në komunat:** *Ferizaj, Ranillug, Vushtrri, Podujevë, Prizren, Klllokot;*
- **Të themelohet Zyra mobile për ndihmë juridike falas, në komunat:** *Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Vushtrri, Mamushë, Shtërpçë, Deçan, Viti, Klllokot, Partesh, Junik, Rahovec.*